



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 481 Prot.

Tiranë, më 20/09/2018

V E N D I M

Nr. 27, Datë 20/09/2018

PËR MIRATIMIN E

**“KODI ETIK I KRYETARIT DHE DREJTUESVE TË LARTË
TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”**

Bazuar në nenet 162/1, 163 dhe 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika “a”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “ Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, sidomos në Standardin ISSAI 30 “Kodi i Etikës” dhe në Standardin ISSAI 12 “Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit-Të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”, me qëllim plotësimin integral të Kodit të Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit,

VENDOSA:

Miratimin e Kodit Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, si përmbledhje e tre dokumenteve kryesore:

Kodit të Etikës së KLSH;

Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe

Standardet Ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-t, në veçanti ISSAI 30 “Kodi i Etikës” i INTOSAI-t.

Neni 1

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, si trupa drejtuese e institucionit që duhet të përcjellë vlerat më të larta dhe të realizojë misionin e kësaj strukture kushtetuese, miratohet dhe hyn në veprim me synim forcimin e mëtejshëm të integritetit dhe transparencës së institucionit suprem të auditimit, i cili drejton nëpërmjet shembullit, mbi bazën e parimit ndërkombëtar “tone at the top(përgjegjësia në rradhë të parë tek drejtuesit)”. Ai mbështetet në tre dokumente kryesore:

- (i) në Kodin e Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, të miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 56 datë 30.04.2015,
- (ii) në Kodin e Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 61, datë 05.04.2018 dhe
- (iii) në Standardet Ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-t.

Neni 2

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së është plotësim integral i Kodit Etik

të institucionit, Kreu “Dispozita të Përgjithshme”, Neni 4, pika 4.3.

Neni 3

Kryetari i KLSH-së, Sekretari/Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve/Drejtorive dhe Kryeaudituesit njohin dhe zbatojnë pa asnjë kusht, me rigorozitet dhe përpikmëri Kodin e Sjelljes së Deputetëve, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 61 datë 05.04.2018 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, punuar me ekspertë të OSBE-së, si një ndër standardet më të larta në vend dhe etalon të sjelljes etike të një nëpunësi të Shtetit, zbatimi i të cilit i mundëson institucionit dhe ekipit drejtues të tij një imunitet të fortë ndaj konfliktit të interesit dhe sjelljeve në dëm të interesave të qytetarit.

Neni 4

Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të çënojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaroi publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe, katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adresoi zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mos rikandidim për t’u rizgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke jua bërë me dije edhe Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit,.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së lexohet dhe zbatohet integralisht në të tre Dokumentet e cituara në Nenin 1 dhe në këtë Vendim.


KRYETAR

Bujar LESKAJ